




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Kryetari i Komunës

Nr. 01-400/04-0054346-2/26 dt. 11.09.2026
Mitrovicë

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, neni 5, dhe neni 14 të Rregullores Komunale Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve dhe Granteve, Vendimi i Kuvendit Komunal me nr. 02-060/01-0042000-3/26 i datës 29.07.2026 dhe pas shqyrtimit të Kërkesës me nr. 01-400/04-0054346/26 të datës 10.09.2026 nga Drejtoria për Mbrojtjen e Mjedisit, Kryetari i Komunës sjell këtë:


V E N D I M

1. **Aprovohet** Kërkesa me nr. 01-400/04-0054346/26 të datës 10.09.2026 nga Drejtoria për Mbrojtjen e Mjedisit, dhe i lejohet shpalija e thirrjes për konkursin komunal për ndarjen e çmimeve për kopshtin, ballkonin panoramik, sipërfaqën me të mirë të rregulluar para lokaleve afariste dhe atyre të gastronomisë, në shumë prej 3,500.00 (tremijë e pesëqind) Euro, konform Vendimit të Kuvendit Komunal me nr. 02-060/01-0042000-3/26 i datës 29.07.2026.
2. **Lejohet** shfrytëzimi i mjeteve të planifikuara dhe atë në shumën prej 3,500.00 (tremijë e pesëqind) Euro në kategorinë ekonomike “Subvencione dhe Transfere për ndarjen e çmimeve sipas paragrafit 1 të dispozitivit të këtij vendimi.
3. Drejtoria për Mbrojtjen e Mjedisit obligohet që ti zhvillojë procedurat konform kriterëve dhe dispozitave relevante të Rregullores Komunale Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve dhe Granteve, Vendimit të Kuvendit Komunal me nr. 02-060/01-0042000-3/26 i datës 29.07.2026 dhe dispozitave ligjore dhe nënligjore nga fusha përkatëse.
4. Konkursi Publik për realizimin e këtij projekti e cila është pjesë përbërëse e këtij Vendimi, së bashku me kriteret do të publikohen në web faqen e Komunës, dhe e njëjta do të qëndrojë e hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga momenti i publikimit.
5. Në përputhje me Rregulloren Komunale Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve dhe Granteve, Vendimit të Kuvendit Komunal me nr. 02-060/01-0042000-3/26 i datës 29.07.2026 dhe me propozimin e Drejtorisë



për Mbrojtjen e Mjedisit, Kryetari i Komunës do të formojë Komisionin Vlerësues i cili do të bëjë vlerësimin e aplikacioneve në përputhje me kriteret e përcaktuara me Thirrjen Publike.

6. Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Drejtoria për Mbrojtjen e Mjedisit, në bashkëpunim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa.
7. Drejtoria për Mbrojtjen e Mjedisit është e obliguar të njoftojë përfituesit për kohën dhe datën e nënshkrimit të Kontratave.
8. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Kryetari i Komunës

Faton PEÇI



Shtojcë:

Kërkesa me nr. 01-400/04-0054346/26 të datës 10.09.2026 nga Drejtoria për Mbrojtjen e Mjedisit;
Vendimi i Kuvendit Komunal me nr. 02-060/01-0042000-3/26 i datës 29.07.2026;
Thirrje Publike për Konkursin Komunal për Ndarjen e Çmimeve.

Ti dorëzohet:

- 1x1 Kryetarit të Komunës
- 1x1 Zyrës Ligjore
- 1x1 Zyrës për Informim
- 1x1 Drejtorisë për Mbrojtjen e Mjedisit
- 1x1 Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- 1x1 Arkivit.

REPUBLICA E KOSOVES
MITROVICA
KOMUNA E MITROVICES